



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

Nr. i Protokollit: 02/ 686
24/06/2025

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e Lagjes së Pajtimit

E hënë, më 09 qershor 2025

Kohëzgjatja e takimit: 17:45 – 19:20

Vendi i takimit: SHF “Emin Duraku”

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryetari i Komunës – Qemajl Aliu, Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i Drejtorisë Për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi- Grejtalb Emini si dhe Asambleisti Besnik Seferi.

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028

Kryetari i Komunës z.Qemajl Aliu: Faleminderit së pari që sot keni gjetë kohë që të jeni pjesë e këtij dëgjimi publib. Unë sot jam këtë së bashku me Kryesuesin e Kuvendit, Adnan Ademi, Gentiana Mehmetin nga kabineti jonë, asambleistin Besnik Seferi si dhe Drejtorin e infrastrukturës, Grejtalb Emini. Ne jemi këtu në kuadër të dëgjimeve publike, ku është viti i katërt me rradhë dhe besoj që ne tashme veçse jemi familjarizuar. Kjo është korniza buxhetore që ne i marrim kërkesat e qytetarëve dhe në bazë të kësaj e hartojm buxhetin e vitit të ardhshëm.

Është mirë që në këto dëgjime publike të marrin pjesë sa më shumë qytetarë që t'i paraqesin kërkesat e tyre, sepse ne jemi qeverisje ashtu edhe sic ju kemi thënë, qeverisje transparente dhe kërkesat e qytetarëve edhe i marrim por edhe i trajtojm shumë seriozisht.

Ju tashmë e keni parë që ne jemi qeverisje transparente dhe llogaridhënëse, prej atyre qeverisjeve që 24 orë krejt cfarë mund e cfarë din nuk e kursjem që të punojm.

Ka dasht Zoti që kësaj rradhe edhe për angazhimin tonë por edhe nga përkrahja e qeverisë në krye me Kryeministrin Kurti, Shtimja ka pasur prioritet edhe kanë ardhur fonde, përvèc buxhetit lokal pra kemi pasur edhe mbështetjen tepër të madhë të qeverisë.

Lagia e Pajtimit ka qenë një nga lokalitetet më të lëna pas dore, por po besoj që tanë jemi në rrugën e duhur dhe investimet tanë nuk mungojn.

Unë ju falënderoj edhe një herë që jeni këtu dhe që keni gjëtë kohë të vini. Ne sot do t'i marrim kërkesat e secilit prej jush ku edhe një herë po e them që bashkë me ekipen time vijm ballë hapur para jush dhe realisht punë të mira janë bërë po ashtu edhe të tjera janë në proces që të bëhen.

Kështu pra të nderuar miq, tanë ne jemi duke e bërë qarkoren buxhetore, këto projekte ne i marrim dhe i integrojmë.

Komuna i ka diku rrëth 2.5 milion euro për investime kaipitale, Komuna e Shtimes i ka dikun 22 vendbanime ne e ndajm buxhetin në mënyrë të barabartë në bazë të numrit të banorëve, ne e kemi barazinë pikë synim jo vetëm teorikisht por edhe e keni parë edhe praktikisht.

Une e di që edhe pse janë kryer shumë punë, ne akoma kemi me kry edhe punë të tjera, me këtë komunikim njerëzor e të hapur e transparent si djem e bija të këtij vendi kemi me ju shërbyer deri në atë ditë ku ju na jepni besimin, dhe dera do të jetë gjithmonë e hapur, mënyra e komunikimit do të jetë e sinqert dhe njerëzore dhe ne as nuk do të kursehem i as nuk do të bëjmë dallime, do të shikojm me rradhë kush ka nevojë për mbështetje sic kemi vepruar edhe deri tani.

Kështu të lirisht na jepni propozimet e juaja për çfarë do nevoje që të keni, duke mos harruar të ju falenderoj për bashkëpunimin që kemi pasur këto 3 vite, duke ju falënderuar po ashtu për prezencën që e keni treguar në dëgjime publike, unë tani ju kisha thënë që t'i tregoni kërkesat e juaja që ato të bëhen ligj dhe vitin e ardhshëm të implementohen.

Kërkesat e banorëve të fshatit :

- **Shpresim Selimi** : Lagjia “Ohri” rryma është shumë e dobët është e nevojshme një trafo e re. Po ashtu shkaku i rrymës ne nuk po kemi as edhe ujë.
Një kërkesë tjetër eshte edhe për rivitalizimin e asfaltit pasi që është dëmtuar mjaft shumë. Kemi nevojë edhe për disa kanale rrëthë asfaltit që të mund të kaloj uji.
- **Avdi Asllani** : Dritat në lagjen “Fazli Grajqevci”
Të asfaltohet aneksë i rrugës “Fazli Grajqevci” (230m asfalt)
Po ashtu një bander është në gjendje te keqe gati duke u rrëzuar.
- **Tefik Salihu** : 50 Ari tokë nuk mund ta punoj për shkak të ujit, aty ka nevojë të bëhen disa kanale kulluese.
- **Avdullah Muhadini**: A keni ndonjë projekt sa i përketë kanalizimit te pishina, pasi që është aroma shumë e keqe.
Po ashtu nëse ka mundësi te përmendorja të hiqen disa tela pasi që janë rrezik për fëmijët. Të hiqen shtyllat e rrëzuara gjithashtu.
Dhe të bëhet mirëmbajtja e varrezave të Lagjes së Pajtimit.
Të vendoset një shenjë te rruga për te varrzat që është rrugë padalje.
- **Ajet Ajeti**: Trotuari të rregullohet nga trafo, po ashtu të vendoset edhe një pengesë në rrugë më konkretisht te trafo, rruga “Anton Çetta”
- **Arlind Misini**: Sa i përketë rrëthit në Lagje si ka mbetur puna?
Në pjesën e pashfrytëzuar të shkollës a ka mundësi të bëhet një park.
Dhe nëse ka mundësi të vendoset nga një shportë për mbeturina në pjesën ku janë rregulluar kockat.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në: *Lagjen e Pagtimit*
Date: *09.06.2025*

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	Shqiprim Selimi	
2	Shaban Selimi	
3	Labinot Jetishi	
4	Tefik Solci	
5	Ajet Ajeti	
6	Arnend Ajeti	
7	Sedmir krasniqi	
8	FLAMUR MUHADHI	F. M
9	Arni ASLLANI	
10	XHEVDETË ASLLANI	
11	Përvorin ASLLANI	
12	Muhamed UKZMOJLI	
13	Arlind Misini	
14	Senador Kodri	
15	Sitet ogjet	
16	FATMIR AJETI	
17		